

PROFETSIT

E
T E

SHTU NIES

E

MADHE

HORA E T' ARBÈRESHËVET 28-III-1965.

P R O E E T S I T

E

T E

S H T U N I E S

E

M A D H E

P i e s a n g a T E B A R I T

(I,1-13)

Tæ zænit 'n fill Perændia bæri kjielliæn e dheun.
2. E dheu ish i pa-tæ dukur e i pa-gjæ fare,e tæ næ-
tertit ish mbi fakjien e honit,e shpirti i Perændis
sillej mbi ujærat.

3. E Perændia tha: u bæft drita e drita u bæ.

4. E Perændia pa se drita ish e miræ,e ndajti dritæn
nga tæ nætertit.

5. E dritæn e thriti ditæ e tæ nætertit natae.

E nbræmie e menatæ u bæ dita e parae.

6. E Perændia tha:u bæft njæ tæ ndejtur næ nes tæ ujæ-
ravet,e kloft kæta næ nes çæ ndan ujæ nga ujæ.

E kæshu u bæ.

E Perændia bæri tæ ndejturit e ndajti næ nes
ujærat çæ janæ sipp tæ ndejturit.

8. E Perændia kæta tæ ndejtur e thriti kjiell. E pa
Perændia se ish miræ. E nbræmie e menatæ u bæ dita e dijtæ.

9. E Perændia tha: le tæ mbæjidhen ujærat çæ janæ
pærposh kjielliæs nbæ njæ vend bashk e le t'duket
tæ termít. E u bæ kæshu. E ujærat çæ ishæn pærposh
kjielliæs,u mbæjodhæn bashk te vendet e 'tire e u duk
tæ termít.

10. E Perændia tæ termít e thriti dhe,e tæ mbæjedhurit
e ujæravet e thriti dejt. E pa Perændia,se ish miræ.

11. E Perændia tha: le tæ shtienjæ dheu bar tæ njonæ,
bar çæ bæn faræ,e dru pemie çæ bæn pemæ:llojet nga-njæ
t'i glasænjæ faræs e 'tijæ ,e tæ jet tek ai fara e
'tijæ te llojeja e 'tijæ mbi dhet.

E u bæ kæshu.

12. E dheu shtu e dha bar tæ njonæ,bar çæ bæn faræ
nbæ llojet gjah fara e 'tijæ,e dru ne pemæ ashtu si
fara e'tijæ ndæ 'tæ nbæ llojet e 'tire mbi dhet.

E pa Perændia se ish miræ.

13. E nbræmie e menatæ u bæ e treta ditæ.

Piesë nga libri i Isaïs Profetas
(LX.1-16)

- Ndritu, ti, o Jerosolimë, pse të jerdhi drita jote
e lëvdia e t'in'Zoti nbi Tij u daftua.
2. Shi', se të mëterrët ka të pështronja dheun, e do t'jet
niegulla nbi gjinden:e nbi Tij ka t'lhet in'Zot
e lëvdia e 'tij ka të duket.
3. E rregjërat ka të jetsian me dritan t'ande e gjindet
me të shkëlkjierit t'at.
4. Ngre sit t'at rrëth e rrötull e shih të mbajedhurë
tu bij e tu bija ka t'jen kjellur nbi krahët.
5. Atë herë do t'shohash e do t'gëzonehë:do t'shkundesh
e të sgjeronet zëmbra, kur tek ti do t'priret buria e
dejtët, e të gjindës e të popujëvet.
6. Lusma kanilesh kanë të vinjën tek ti e kanë të të
mblojën kamilet e Madhianit edhe të Jefas. Të gjithë
nga Saba do t'vinjën tue prur ar e klem(livan) e gur të
çnuam, e do t'ligjirojën të shpëtuarit e t'in'Zoti.
7. E delet e kjidharit të gjithë kanë të mbajidhen tek
ti:e ka t'vinjën tsiept e Nabeothit, e të pritur ka
t'jen falur nbi theroren t'ine:e shpia e lusis t'ine
ka t'jet lëvduar.
8. Kush janë kasta që shpeit venë si niegulla e flutu-
rojën si pallumbesha me zokjt e 'tire nbi mua?
9. Mua në presiqen ujthesat e lundrat e Tarsit që në
parapara,, sa të t'bie tij tu bij nga vende 'n së largu
e bashk me ata, rrëgjëndin e arin e 'tire:paj t'enbrit
sheit e t'in'Zoti, e pajë, t'jet i lëvduashëm Sheiti i
Israelit.
10. E të huajit kanë të ndërtojën muret t'at, e rregjë-
rat e 'tire do t'stenen tij sa të t'shërbëjën:se te
mbria jine u t'ksita e te lipisia u të desha mirë.
11. Diert t'ote kanë të jen të shëllime gjith herat:
ditë e natë ngë kanë të mbillen, sa të këllitet tek ti
fukjia e gjindevet edhe rregjërat e 'tire që tij të bien.

12. Përse gjindet edhe rregjarat çë ngë do t'sherbejën Tij , kanë të sbiren,e ato gjinde si të shkretë ka t'jen shkretuar e përfaruar.
13. E lëvdia e Livanit ka t'vinjë tek ti me kijiparise,me pefkje e me kqedhre sa të lëvdonjë vendin e këmbëvet t'ime.
14. E kanë të vijën tek ti të trëmburë të bijt e atire çë tij të shtun posht e të shkarzien. Kanë të përmisen te gjurmët e këmbëvet t'ote gjithë ata çë të shkarzien.
15. Se ti ishie lëna e vetëm,e harruame e ndë mbëri të gjithëve,e ngë ish njeri që vij e të ndihëj.
E u dua t'jesh lëvdia te gjithë notet , gëzimi te gjithë jinit.
16. E ti ke të thithësh klumësht gjindesh , e ke të hash kjoësmë rregjërash:e ke të dish,se U jam i Zoti çë të ruanj ,jam U çë të lironj, Perandia i Israelit .

v a s h d o n n g a f.4:
këputset te këmbat,shkopin te duart e do t'hani
shpeit shpeit:se këto janë Pashkët , të
shkuarit e t'in'Zoti.

P i e s a n g a t e D A L E T
(XII,1-11)

In'Zot i foli Moiseut e Aaronit næ dho t'Egjiptit, tue thænæ:

2. Ki muaj isht pær ju kreū i muajævet:pær ju isht i pari ndær muajit e vitit.
3. Ti flit te gjithæ nbæledhia e tæ bijvet t'Israelit e thuaji atire:tek e dhictæta ditæ e kætij moi nga-njæ le t'marrænjæ njæ kjenkj pær nga shpi tæ fæmijæs 'tijæ:nga-njæ njæ kjenkj pær shpi.
4. Næ pra u ndothshin pakæ veta te shpia, akjæ sa ngæ arræjæn t'e han kjenkjin, ai le t'marrænjæ me 'tæ gjito-nin çæ ka næ afær shpis e 'tijæ, pærsa isht numri i shpirtravet:nga-njæ tæ jet næmruar pærsa i duhen tæ han kjenkjin.
5. E kjenkji ka t'jet i tæra, pa dserkje, nashkull e nji viti: ka t'e mirni nga kjenkjet e nga katsikjt.
6. E ju ka t'e ruani njera tek e katrambædhietæta ditæ e kætij muaji:e gjithæ shuriza e nbæledhies e tæ bijævet t'Israelit nga-njeri ka t'e therænjæ nbæ tæ ngrisurit e ditæs.
7. E ka t'marriæn nga gjaku i kjenkjet e ka t'liejæn di furkjet-anæt-e deræs e prakun e sipræn tæ deræs tæ shpivet, ku ata ka t'e han.
8. E tek ajo natæ ka t'hæn nishæt e kjenkjet tæ piekur te ziarri, ka t'hæn buka tæ gjeshur pa bruni tæ ngridhur me barin e pikridhes.
9. Ka kjenkji ngæ ka t'hæni gjæ tæ pa-piekur, jo tæ zier te ujæt, po tæ piekur te ziarri:ka t'i hæni kriet, kæmbæt edhe brændeshat(zorræt).
10. Ngæ ka t'i læni gjæ, njera menatnet:e ngæ ka t'i çani njæ asht. Næ edhe vietet gjagjæ; njera menatnet ka t'e digjæni te ziarri.
11. E ka t'e hæni kæshtu:mesin shtrænguar ne rrothin,
(vazhdon næ f. 3.)

Piesë nga libri i JONES Profeta
(III,1-10;IV,1-11)

- Jonas tæ birit e Amathit in'Zot i foli e i tha:
2. ngreu e jets te kjiteti i nath ndæ Ninivæ:atiè lirò e kjarto, se thirma e tæ kekjævet e 'tire arru njera tek U.
3. E Jona u ngre tæ jikøj pær Tarsin nga fakjeja e t'inæ Zoti:e vate pær Jopan,e gjeti njæ lundræ çæ vej ne Tars 'n sæ largu nga fakjeja e t'in'Zoti.
4. E in'Zot smoli njæ eræ e fortæ mbi dejtin e u ngrenæ suvala tæ madha te dejti e lundra kish dre tæ plasaj.
5. E dejterat ishæn tæ dreruanæ e nga-njæ thrisæj Perændin e 'tij:e nuarnæ tæ shtijan te dejti lagjit e çæ-do barræ kishæn te lundra,sa t'e lehtæsojan. Po Jona posht te fundi i lundræs u shtu tæ flæj e rræfallisaj.
6. E ju kjas kaptenja e i tha: E çæ,ti rræfallis? Ngreu e thrit Perændin t'ænt,næ do tæ na shpætonjæ Perændia e mos tæ sbireni.
7. Pran thanæ njeri t'jatrit ndanzæ:ejani e shtiem shortat e shorta i ra mbi Jonan.
8. E ata i thanæ atij:pa daftona ti,pærçæ na kle neve kæjo e zezæ? Çæ puna ke ti? e ngaha vien,e ku vete? e nga çila horæ e faræ gjindesh je ti?
9. E ai i tha atire: u jan ebrè,shærbætar i t'in'Zoti: e i falem Zotit Perændi tæ kjielliæs,i çili bæri dejtin e dheun.
10. E u trænbæn ata burra ne njæ dre tæ madhe e i thanæ atij:pærçæ ti bære kæte shærbes?pse ata burra ndælguaan se ai ish i jikur nga fakjeja e t'in'Zoti, se ai ja kish rræfier.

11. E ata i thanë atij:çë kemi të të bëjën tij, sa të sbutsonet dejti me ne? pse dejti në çë vej, në shumë ngrëj suvalat.
 12. E Jona i tha atire:na mirni e në shtini të dejti, e ngak ju do t'largonet dejti. Përçë u e di se për mua janë nbi ju këto suvala të mbëdhë.
 13. E ata burra bëjën fukji, sa të prireshën të dheu, e nga mëndë ja bëjën, se dejti në çë vej në shumë ndrashej nbi ata.
 14. E zun të lurijan tek in'Zot e thoshian:Zot, mos klo-fshit! Mos të sbireni për gjellën e këtij njeriu, e mos na shtie ngrah nbi ne gjak të drejt; pse Ti, o Zot, ke bër ashtu si deje.
 15. E muartin Jonën e e shtun të dejti e dejti u nba naga vala e 'tij, sosi të tërbuari.
 16. E ata burra me një dre të madhe ju trëmban t'inë Zoti e i falën t'in'Zoti flijë e ju lutën me urata e me të taksurë.
- II, 1. E in'Zot i kish urdhuruar njij pishku të nath sa t'e gjëllij Jonën: e mbeti Jona te barku i pishkut tri dite e tri netë.
2. E Jona nga barku i pishkut zu t'i lutej Zotit Perëndi e thëshqaj:
 3. Te helmi jin u i thirra t'in'Zoti Perëndis t'im e Ai n'u përgjekj: thirma jine nga barku i varrit e Ti në gjegje zërin t'im.
 4. Ti në shture humbët në mes të dejtit: e lume ujë në rrëthuan: të gjithë valat t'ote e suvalat shkuant nbi mua e në pështruan.
 5. E u thash:jan i përzëmë në vend 'n së largu sivjet t'at: nbi gjithë u do t'thon se kan të shoh panëta faltoren e sheitëris t'ande.

6. Ujxet næ ka pəshtiellæ njera te shpirti:honi næ i humbat næ ka rrəthuar:kriet t'in' humbi posht.
 7. brända dheut,ku prəngat e 'tij e mbajən gjith-nona. E nga humbia le tæ ngrəhet tek Ti gjella jime,o Zoti, Perəndia jin.
 8. Kur ish e næ shkulej shpirti i jim,u kujtova u ka in'Zot:e jarshit tek Ti lusia jime te faltoreja e sheitaris t'ande.
 9. Ata çə ruajən tæ kota e tæ rreme,ata lərejan par 'ta lipisin.
 10. Por me zæ lavdije e lavdarije dua tæ t'fal Tij flija:sa-do tæ taksa ndæ uratæ,kan tæ t'e jap par shpətimin t'in:se shpətimi isht i t'in'Zoti.
 11. E in'Zot i dha urdhuri:nin pishkut e pishku e ndsori jashta gojwə Jonən,e e la næ dhe tæ tern.
- III,1. E in'Zot i bæ fialæ Jonæs tæ dijtæn heræ e i tha: Ngreu e jets te kjiteti i math ndæ Ninivæ e atiè thirr e ligjiro ashtu si næ para tæ bæra fialæ.
3. E Jona u ngre e vate næ Ninivæ,ashtu si i foli inæ Zot. Niniva isht njæ kjitet shuna i math,si tri dita tæ jetsur.
 4. E Jona hiri brända horæs e zu tæ jitsæj si njæ ditæ dhron:e thərrisæj e thosħæj:edhe di-zetæ ditæ e Niniva ka t'jet gorronistæ.
 5. E ata tæ Ninivæs patæn besæ te Perəndia:e urdhuruan argjærin e u veshən me these tæ gjithæ,çə ka næ i nadhi i 'tire njera te næ i vogali i 'tire.
 6. E fiala arru rregjit e Ninivæs:ai u ngre nga throni i 'tij,e shtu næ nj'anæ petkat e 'tija,e u vesh me njæ thes e u uj nbæ hi.
 7. E kle shtur thirma e ú tha ndæ Ninivæ par urdhur tæ rregjit e tæ ta Mbədhenjavet,tuc thonæ:burrat edhe kafshat,kjet edhe delet mos tæ ngjepsian gjæ,mos tæ kù-lotian,mos tæ pin edhe ujæ.

8. E ata u pështruan me these, burra e kafsha e thritan fort e glat Perandin e nga-një u pruar nga dhroni i 'tire i kekji e nga pa-ligjëria e 'tire, çë kishën par duarshit e 'tire.
9. Ata thoshiën:kush e di në Perandia do t'ndarronjë mend e do t'jet parkalest të na ndëjenjë, e do të kathet nga tërbimi i mbaris e 'tij, e na të mos sbiremi?
10. E Perandia pa veprat e 'tire se u pruarën nga udhast e 'tire të kekje:e ndarroj mend Perandia e pati lipisi e la mos t'i bëj atire të ligën çë kish thënë, e ngë ja bari. IV,1. E u helmua Jona ne një helm të math e u trazua, e zu t'i lutej t'in'Zoti e t'i thashqj: o Zot, ngë ishën këto të folat t'ime, ku edhe ndodhesha të dheu i jin? Prandai u shpeit mora të jikia në Tars, pse u e dija se Ti je i but, i lipisis, i zëmberëgjerë, se të duket kekjë shumë e se ndajen të kekjiat.
3. E nani, Zot e i zot, mirë shpirtin so isht në mirë par mua të vdes se të rronj.
4. E in'Zot i tha Jones:isht mirë se ti t'u kesh mbërijtur kështu?
5. E Jona dolli jashta kjitetit e vate e u vu n'ball të kjitetit:e atie bari par 'të një kalive e mbeti përposh asaj në hjë njora kur të shihqj çë ki't'i streksaj kjitetit.
6. E Zoti Perandia urdhuroi nji urdhi e u rrit e u ngre mbi krijet e Jones sa t'i bëj hjë atiè sipr mbi krijet e 'tij, sa t'e prëj nga helmet e 'tij; e Jona ne urdhin pati gëzim të math.
7. E Perandia mbë nesër dargoi një krimp si ish e dihej atë menatë, e krimbi rrahu e shpoi urdhin, i qili u u sverth e u tha.
8. E të dalët dielli,streksi se Perandia urdhuroi njij e rie të ngrohtë çë digjaj:dielli i ra mbi krijet e Jones

e ai u zalis,e dishiroj tæ vdisæj,e tha:mæ miræ pær
mua tæ vdes , se tæ rronj.

9. E Perændia i tha Jones:tæ duket miræ,se tæ nbriheshe
pær urdhin? E ai tha:se fort u kam helmuar u njera tæ
vdisia.

10. E in'Zot i tha:ti deshe tæ kurseje urdhin,tæ tæ du-
kej kekj pær atæ urth pær kæ ngæ reve gjæ,ngæ e bærc
ti tæ rritej:ai te njæ natæ leu e te njæ natæ vate.

11. E u ngæ ka t'kursenj Ninivæn,t'e ndæjenjæ njæ kji-
tet tæ math,teku jesiæn næ shumæ se njæ kjint e njæ zet
mijæra njeræzish,tæ çilæt ngæ din tæ njohiæn tæ dreitæn
doræ e 'tire e tæ shtræmbæræn e 'tire,me disa kafsha ?

Piesæ nga libri i JOSUEUT
(V,10-16)

Tæ bijt e Israelit u mbajtin atiè næn tendævet ndæ Galgabæ e bæn Pashkæt mbæ tæ ngrisurit e ditæs katræ-
mbædhietatæ tæ t'parit muaj, te fushat e Jerihoit mbæ
at'anæ tæ Jordhanit, nga hump dielli.

11. E mbæ nesær tæ Pashkævet te jatæra ditæ ata hæn-
græn nga drithæt e atij dheu bukæ, tæ gjeshur pa brum
tæ ngridhur, e tæ ri tæ atij viti.

12. E posa çæ ata hajæn nga ata drith tæ dheut, i sosi
atire manna, e tæ bijt e Israelit ngæ patæn næ mannae.
E tek ai vit u ushkjen tue ngrænæ nga pamæt e dheut
tæ Kanaanit.

13. E streksi se, si ndodhej Josueu nd'anæzæ tæ Jeri-
hoit, ngræjti sit e 'tij e pa njæ burr shtuara ne
shpatæn e helkjur jasht, te dora e 'tij:e Josueu ju
kjas atij e i tha:je ti nga t'anæt a nga armikjt?

14. Ai mori e i tha: u jam krie e ushtris e t'in'Zo-
ti, jam e vinj nani.

15. E Josueu i ra præmist atij te dheu, e ju fal e i
tha: o Zot, çæ urdhuron ti shærbætorit t'ænt?

16. E ai i tha Josueut:sglith kæputset e ndsiri bga
kæmbæt t'ote:pse vendi ku je e rri, æ i sheit.
E Josueu bæri ashtu.

Piesæ nga tæ DALÆT
(XIII,20-22; XIV,1-31; XV,1-9)

Tæ bijt e Israelit nga Sokothi u ngrenæ e vanæ e shtruuan tendæt næ Othon; nba buzæ tæ shkretiræs.

21. E Perændia i vej pærpara,ditæn ne njæ shtilla mie-gullie,sa t'i mbæsoj dhromin,e natæn ne njæ shtilla ziarmi,sa t'kishæn dritæ.

22. Pærpara gjithæ popullit ngæ ju lips shtilla e mie-gullæs ditæn,e shtilla e ziarmit natæn.

1. E in'Zot i foli Moiseut e i tha:fliti tæ bijvet e Israelit e thuaji tæ kæthehen prapa:le tæ vun tendæt pærpara atij fshati,Piharihothi,çæ isht næ mes tæ Magdolit o tæ deitit næ ballæ tæ Beelsefonit:pærpara kætire vende ti ke tæ shtrosh tendæt te ana e deitit.

3. E Faraoni ka t'i thet popullit e 'tij:kæta bij tæ Israelit janæ tæ sbierræ ndæ atæ dhe:pse shkretira i ka mbillur brenda.

4. U ka t'hanj zæmbræn e Faraonit:e ai do t'i ndiekæ-njæ t'i ve prapa atire:e U kan t'jem lævduar nbi Fara-onin e nbi gjithæ ushtrin e 'tij :e kanæ tæ njohian tæ gjithæ Egjiptsianæt,se U jan Zoti Perændia:e ata bæn ashtu.

5. E i kle rræfier rregjit i Egjiptsianævet,se populli i Israelit kish jikur:e zæmbra e Faraonit edhe tæ shærbætorævet e 'tij u ndærrua e u pruar kundra popul-lit,e ata thanæ:çæ keni bær na kæshtu?t'i læjæn tæ ve-jæn tæ bijt e Israelit,tæ mos na shærbejæn neve?

6. Andai Faraoni bæ t'i væjæn kuejt kjerrit e 'tij e mori me 'tæ popullin e 'tij.

7. E mori gjasht kjint kjerre tæ sgledhuræ e gjithæ

kalorin e Egjiptsianavet e krerat mbi ta gjithae.

8. E in'Zot thajti zembran e Faraonit, rregjit t'Egjiptit edhe ta sherbatoravet e 'tij, e ai ndokji ta bijt e Israelit e i vate prapa. Por ta bijt e Israelit kishen dala nga Egjipti nbae dorae ta t'Lartit Perandi.

9. Egjiptsianat i ndokjan tue vatur prapa atire e i gjeten kur kishen shtruar tendat afær deitit:e gjitha kuejt edhe kjerret e Faraonit, e kalorat e ushtria e 'tija ishen parpara atij fshati, Piharihothi, n'balla ta Beelsefonit.

10. E Faraoni kjasej; e ta bijt e Israelit, si ngrajtin sit, pan Egjiptsianat qa vajen tendat atie, prapa atire e u dreruan fort ta bijt e Israelit e zun ta therrisiem t'in'Zoti.

11. E i thana Moiseut:mos ngae ishen varre na Egjipt e na holkje jashta, ta vdisiem katu te shkretira?

Qa na bare kashu neve, ta diliem nga Egjipti?

12. Ngae ish kajo fiala, qa na ta baje na Egjipt, kur ta thoshiam:lena katu neve, ta sherbajen Egjiptsianat, se per ne isht na mira ta sherbajen Egjiptsianat, se ta vdesiam te kajo shkretirae.

13. E Moiseu i tha popullit:mos traembij:rrini e varreni shpatinin e Perandi, qa sot Ai ka t'ju benja:perqa Egjiptsianat qa kini par sot ju ngae kini t'i shihni na per gjith mona.

14. In'Zot ka t'luftonj per ju, e ju kini ta kjetij.

15. E Perandia i tha Moiseut: qa na tharrret mua? Fliti ta bijvet e Israelit:le ta zen dhromin.

16. E ti ngre purtekane t'ande e ndej doran t'ande nbi deitin e ndaje 'n dish:e le t'shkojan ta bijt e Israelit na nes ta deitit per na dhe ta term.

17. E shi'se u do t'thanj zembran e Faraonit e ta gjitha Egjiptsianavet, e ata ka t'hijen branda deitit prapa atire.

e dua tæ ken lëvdi mbi Faraonin e mbi gjithæ ushtrin e 'tijæ, e mbi kjerret e mbi kuejt e 'tijæ.

18. E kanæ tæ njohiæn Egjiptsianæt se U jam Perændia, kur t'jen lëvduar te Faraoni e te kjerret e te kuejt e 'tijæ.

19. Ahierna ængjælli i Perændis u ngre tæ nisej tue shku-
ar pærpara ushtris e tæ bijvet t'Israelit, e u vu tæ ji-
tsæj prapa atire: ashtu edhe duall shtilla e miegullæs
nga fakjeja e 'tire e u mba prapa atire:

20. E hiri pær næ mes tæ ushtris tæ Egjiptsianævet e tæ
ushtris t'Israelit, e u mba. E u bæ mæterræt edhe bæ dritæ
natæn:pse te ana e Egjiptsianævet miegulla ish e mæterte,
te ana e bijvet t'Israelit ish njæ dritæ çæ natæn i dæf-
toj dhronin:njera ushtri ngæ u pærzie me t'jatran gjithæ
natæn.

21. E Moiseu ndeiti doræn mbi deitin:e in'Zot ne njæ era
e fortæ e niesditæs, gjithæ natæn, holkji deitin e e bæ tæ
term deitin: e ujæt u nda 'n dish.

22. E hijtin tæ bijt e Israelit næ mes tæ deitit ndæ tæ
term:pse ujæt e deitit ish si njæ mur te ana e dreitæ e
si njæ mur tek e shtrænbæra.

23. Egjiptsianæt i ndokjæn e hiræn prapa atire; e gjithæ
kuejt e Faraonit e kjerret e kaloræt næ mes tæ deitit.

24. E menatnet streksi mbæ heræ çæ bæn ndritçullæ, se
Perændia ndæ shtilla ziarni e miegullie shtu siun mbi
ushtrin e Egjiptsianævet e e prishi ushtrin e 'tire.

25. E i ndsori rotæt kjerrævet, e i holkji me rræmbin.
E thanæ Egjiptsianæt:jikiæn nga fakjeja e Israelit, se
Perændia lufton pær 'ta kundra neve.

26. In'Zot i tha Moiseut:ndej doræn t'ande mbi deitin
e le tæ ve te vendi ujæt, e le tæ poshtronjæ Egjiptsianæt,
mbi kjerret e mbi kaloræt.

27. E Moiseu ndeiti dorən mbi deitin,e ujət u pruar te vendi,kur ish e gdihej dita:Egjiptsianat jikian pər næ uit:e in'Zot i rrəmbeu e i shtu næ mes tə deitit.
28. E ujət si vate te vendi pəshtroi kjerret e kalorət e gjithə ushtrin e Faraonit çə kishən hijtur brända deitit prapa Israelit:e nga ata ngə e shkaptai edhe njə.
29. Por tə bijt e Israelit jetsən mbə dhe tə term næ mes tə deitit:e ujərat atire ishən si njə mur te ana e dreita e si njə mur te ana e shtrəmbərə.
30. E tek ajo ditə Perəndia ruajti Israelin nga duart e Egjiptsianəvet :e Israeli pa Egjiptsianat tə vdekur mbə buzən e deitit.
31. E Israeli pa dorən e t'in'Zoti tə madhe,atə çə bəri in'Zot Egjiptsianəvet:e populli ju trəmp t'in'Zoti , e patən besə te Perəndia e te Moiseu shərbətori i 'tij.
- XV,1. Ahierna Moiseu e tə bijt e Israelit i kənduan t'in'Zoti kətə kənkə tue thənə:"Le t'i kəndojañ Perəndis:se u lævdərua Ai nc lævdərim:shturi te deiti kali e kalorin.
- 2.Perəndia isht fukjia jime e kənka jime:se Ai kle nua shpatini i jim;Ai isht Perəndia i jin e u po dua t'e lævdonj.Perəndia i prindit t'in isht Ai e u po dua t'e lartəsonj.
3. Zoti,trimi i fort ndə luftə.Perəndi isht embri i 'Tij.
4. Ai shturi te deiti kjerret e Faraonit e ushtrin e Atij:tə sgledhurit,tə Parət krie-luftarə e atij Farao-ni,i humbi Ai te deiti i kukj.
5. Ujərat e kthella i pəshtruə:ata humbən te fundi i deitit si njə gur. 6. E dreita e jote,o Zot,u lævdərua næ məndie:e dreita e jote,o Zot,drəmoi arnikjt.
- 7.Edhe te madhəria e jote e lartə Ti prishe gjithə ata

çæ vun ballæ me tij.Læshove mbarin t'ænde:kæjo i gjel-liti ata si njæ fill kashtie.

8. E me tæ frijturit e tærbinit t'ænt u nda ujætu ngræ-jtin lart suvalat stavæ stavæ,sa bashk kjandruan si njæ mur:ujørat e kthella vanæ e u ngulæn næ mes tæ deitit.

9. Armiku kish thænæ:u ka t'i ndiek,ka t'i arranj. Kam tæ ndanj tæ ubaræn e 'tire,e do t'nglinj shpirtin t'in: u ka t'helkj shpatæn t'ime;dora e jime ka t'i pærforonja.

10. Dærgove Ti,o Zot,frimæn t'ænde e deiti i pæshtroi ata:humbæn si plumbi te ujæt tæ frikæshim.

11. Kush æ si Ti,o Zot,ndær tæ fortit? Kush æ si Ti i lævduashæm næ sheitæri? i famasæshim næ lævdi,tue bær nærakulla?

12. Ndejte tæ dreiten t'ænde , e dheu i pærpijti.

13. Me lipisin t'ænde i dæftove dhronin kætij populli çæ Ti shpärbleve;e me fukjin t'ænde e kjelle nbæ vend tæ sheitæris s'ate.

14. Gjindet e gjegjæn e u dreruan:ata çæ jesian te Fili-stea,u dhæmbæn,mos t'i zæjæn atire vendet.

15. Ahierna u shkundæn tæ Paræt e Edhonit,e shpejt u smolæn tæ Mændænit e Moabit:atire i zu dridhma;u llavæn gjithæ ata çæ jesian ndæ Hanaan.

16. Frika e dreja i raft nbi 'ta ne mændien e krahut t'ænt,o Zot;kjændrofshin si guræ,mos u tundæshin njera tæ shkoft ki popull jiti,kuj Ti je i Zoti.

17. Kælliti,o Zot,e væri ndæ mal tæ trazhgimit t'ænt, ndæ vend ku Ti do t'i jesæsh,ndæ Sheitore çæ Ti ngræ-jte ne duar t'ote.

18. Perëndia ka tæ rregjeronjæ gjith monæ e mbi notin edhe tæ tieræ.

L9. Se hiri kaluar Faraoni te deiti me kjerret edhe kalorët, e mbi ata Perëndia i prori ujat e deitit.

Tæ bijt e Israelit shkuan næ mes tæ deitit, skur jitsian mbi njæ dhe tæ term.

Piesë nga Libri i Sofonis Profetë
(III,8-15)

In'Zot thot këto fialë:rri e në prit, o Jerosolimë, te di-
ta e të ngjallurit t'im për deshmë; pse vullimi i jim isht
ki:të mbajidhen bashkë gjindet e të në vijën rregjërat:
dua të derth mbi ata gjithë mbërin e tërbimit t'im:se
nga ziarri i të nzehtit t'im ka t'jet jostë gjithëjeta.
9. Se ahierna dua mbi popujit të ndërronj gluhën te jinjt
e 'tire, sa të thresian të gjithë enbrin e t'in'Zoti; t'e
shërbëjan nën nji sgjedhe të vetëm.

10. Andai ka lunet e Etiopis kam të pres u, të vijën ata
gë në luten: të bijt e popullit t'im të shprishur ka t'më
bien dhuretit e 'tire. *Ka*

11. Tek ajo dita ti ngë të ngukjesh për gjithë të bë-
nat t'ote, ne të cilat po karkove të në ftesie: se ahierna
dua të ndsier për në nest kak ti shkarzinët e madhështis
t'ënde, e ngë do t'vetësh tue u lëvduar madhështare për
malin t'im të sheit.

12. E brënda tek ti kam të lë një gjindezë të vapsë e të
butë:e ata ka t'jen ponistë paj t'enbrit e t'in'Zoti.

13. E nga Israeli ata çë kjëndrojën, ngë do t'bëjan pa-
dreitëri e ngë do t'thom të kota:e mos t'u gjëndashit te
goja e 'tire gluhë gjenjeshtrie:përqë ka t'ken ata ku të
kulotian e ku të prahen, e ngë do t'jet edhe kush t'i
trëmbanjë.

14. Gëzou fort, o e bija e Sionit; ngre zarin e lëvdo, o
e bija e Jerosolimës: ngushullou e kënakju ne gjithë
zëmbëran t'ënde, o e bija e Jerosolimës.

15. Se in'Zot të ndëori 'ngrahëshit gjikimet t'atë:të ka
shpërblier 'nduarshit e armikjëvet:rregji i Israelit,
Perëndia, isht në mes të tij:ti ngë ke të shohësh në gjë
të kekjë.

Pi  s   nga libri i tret i rregj  ravet
(XVII, 8-24)

In'Zot i foli El  s e i tha:

9. Ngreu e jets n   Sarepta t   Sidhon  s:shi'se ati   u kam urdhuruar nji gruaje t   ve, t   t'japanj   t   ngr  n  .

10. E ai u ngre e vate n   Sarept  :e jerdhi mb   der   t   kjitetit:e shi'se ati   ish nj   grua e ve        nb  jidh  j dru e i thirri asaj prapa e i tha:mirma tsa uj   te nj   lagj   sa t'pi.

11. E ajo ish e vej t   ja mirr  j;e Elia prapa i thirri: b  n  ma hir,bier  m   edhe nj   tsop   buk   te dora jote.

12. E i tha gruaja:rroft in'Zot Per  ndia jit! si ng   kam u buk  ,po kan vet  m sa nj   grusht mielli te pot  jeja e nj   pik   vaji te rrogjeja:e shi' se u jam e nba-jeth di limishte,e hinj br  nda e ka t'e b  nj p  r mua e p  r t'im bir:t   ham e pra t   vdesiam.

13. E asaj i tha Elia:b  n z  mb  r  :jets e b  n ashtu si ti the. Por b  n p  r mua n   par   nj   pet  z  (t   piekur n  n hirit)e m'e bie:p  r tij e p  r t'  t bir b  n pran:

14. se k  shtu thot Per  ndia i Israelit:pot  jeja me miell ng   ka t   sos  nj   e rrogjeja me vaj ng   ka t   menj  , t   lipset,njera te dita kur in'Zot t   na japanj   shiun mbi fakjen e dheut.

15. E gruaja vate e b  ri ashtu si i tha Elia:e h  ngri ai edhe ajo e i biri i 'saj.

16. E    tek ajo dit   pot  jeja mielli ng   u jos e rrogjeja vaji ng   sosi mbi fial  n e t'in'Zoti    tha p  r goj   t   El  s.

17. E streksi pran, se u səmur i biri i asaj gruaje, tə zonjəs e shpis, e səməndia e 'tij ish shumə e rəndə nje-ra çə tek ai u lips frima.
18. E gruaja i tha Elis:o njeriu i Perəndis, çə kam u ne tij? Çə hire tek u tə mə kujtoje tə ligat t'ime e tə mə vdisəj diali jim?
19. E gruas Elia i tha:bier mua t'ət bir: e e mori nga gjiri i asaj e e kjelli lart te dhoma ku ai jisəj e e vu glat mbi shtratin e 'tij.
20. E Elia ngrəjti zərin tek in'Zot e thoshəj:mieri u! o Zot, ti je deshmuar e sə ves, me kə u jam e jes, ti ti nani e ke helmuar akjə sa t'i vdisəj diali i 'saj.
21. E frijti tri herə mbi dialthin e thriti t'ənə Zonə e thoshəj:o Zot, Perəndia jim, le t'i vinjə pame-ta brənda shpirti i katij diali.
22. E u bə ashtu: In'Zot gjegji zərin e Elis e u pruar brənda tek ai dialə shpirti i 'tij:se thriti dialin e u ngjall.
23. Elia e mori nga dhoma e 'tijə e ja kjelli posht e ja dha sə jəməs. E Elia i tha:shi'se it bir ə gjallə.
24. E gruaja nisi e i tha:shi'se jam e njoh, se ti je njeriu i Perəndis, e fiala e t'in'Zoti te goja jote isht e værtətə.

Piesæ nga libri i Isaïs Profet
(LXI, 10-11; LXII, 1-5)

Le tæ gæzonet tek in'Zot shpirti i jim:se Ai mæ veshi me mændilin e shændeties,e mæ pæshtolli me tæ veshuræn hareje. Si nji dhændærri mæ vu kuroræn, si njæ nuse mæ stolisi me bukuri.

11. E ashtu si dheu bæn tæ rritet luleja e 'tijæ, e si kopshti shtie tæ dajæn faræt e 'tija:ashtu Perændia do t'mæn't'lehet dreitæria e gæzimi pærpara gjithæ gjindeve.

1. Pær Sionin u ngæ dua tæ kjetem, e pær Jerosolimæn u ngæ dua t'e sos, njera çæ tæ dalnjæ dreitæria e jime, si njæ ill çæ shkælkjen, Shændetia e jime si njæ dritæ çæ dhizet.

2. E gjindet kanæ tæ shohiæn dreitærin t'ænde, e gjithæ rregjærat lævdin t'ænde: e ka tæ t' thresiæn Tij me njæ embær tæ ri çæ Perændia ka t'i thet.

3. E ti ka t'jesh njæ kuroræ bukurije te dora e t'inæ Zoti e njæ diadhemæ rregjærije te dora e Perændis t'ænt.

4. E ngæ ka t'jesh thritur mæ "e harruameja" e dheu jit ngæ ka t'jet thenæ mæ "shkretiræ": se kanæ tæ tæ then tij "e dashura jime", e dheut t'ænt "e jesura": se t'in'Zoti i pækjeve e se te dheu jit kanæ t'i jesian.

5. E si vete e rri njæ dial me njæ virgjæreshæ, ashtu kanæ tæ jesian tu bij me tij. Si dhændærri ka gæzimin me nusen, ashtu in'Zot ka tæ gæzonet me tij.

Piesæ nga tæ BÆRIT
(XXII, 1-10)

Posa çæ shkuan kæto çæ kemi thænæ, streksi se Perændia deshi tæ ngisæj Abramini e i tha atij: Abraam, Abraam. E ai tha: gjegjem.

2. E in'Zot i tha:nirr t'æt bir, tæ vetæmin, Isakun çæ ti do miræ, e jets nbi atæ dhe tæ lart:atie ka tæ m'falæsh mua pær flijæ gjith-tæ-diegurshime, mbi njæ mal çæ u kam tæ t'e thom.
3. Andai Abrami, tæ bærit ndritçullæ, njize u ngre, nglakoï gomarin e 'tij e mori me 'tæ di veta nga shærbætoræt e 'tij edhe Isakun tæ birin e 'tij:çaiti drut pær flijæn gjith-tæ-diegurshime, u ngre e vate:e jerdhi te vendi çæ in'Zot i kish thænæ.
4. Tek e treta ditæ Abrami ngræjti sit e 'n sæ largu pa atæ vend.
5. E i tha Abrami shærbætorævet e 'tij: ju rrini katu me gomarin:u e dialthi do t'vemi njera kætie, e posa çæ kemi bær tæ luturat, do t'kæthehemeti tek ju.
6. Mori pra drut pær flijæn, e ja vu ngrah Isakut tæ birit 'tij; e mori te duart ziarrin edhe thikæn e tæ di bashk zun tæ jitsiæn.
7. Isaku i tha Abramit tæ jatit:tate, e ai tha:çæ isht, bir? E tha:shi'ziarrin edhe drut, e ku isht kjenkji pær flijæn çæ ka t'diegiæm?
8. E Abrami i tha:Perændia pær 'tæ do t'shohænjæ t'e gjenjæ kjenkjin pær tæ diegur, o bir.
9. E vejæn tæ di bashk e jerdhæn te vendi çæ i kish thænæ Perændia. E ndærtoi Abrami atie theroren, e sipr

i vu drut:e lidhi Isakun tæ birin e 'ij,e e vu mbi theroren atie sipr mbi drut.

10. E ndejti dorən e 'tij tæ mirrəj thikən,tæ therəj tæ birin e 'tij.

11. E njæ ãngjæll i t'in'Zoti nga kjiellia e thriti e i tha: Abraa, Abraam . E ai tha: gjegjen.

12. E i tha ãngjælli:mos ndej dorən mbi dialthin,mos i bən gjæ atij,se nani njoha ,se ti i træmbe Perəndis e þær mua ngæ kurseve birin t'ənt tæ dashurin.

13. E Abrami,tæ ngrajturit sit,pa njæ dash næ mes tæ drizævet,tæ mbajtur þær brish. E Abrami vate e mori dashin e ja fali Perəndis þær flijæ tue ja diegur gji-thæ næ vend tæ Isakut,birit 'tij.

14. E Abrami embrin e atij vendi e thriti "Zoti ka t'e shohænjæ";sa thonæ edhe sot "te mali Perəndia do t'e shohænjæ".

15. E ãngjælli i t'in'Zoti nga kjiellia nj'etra heræ e thriti,

16. tue thænæ:u bæra be mbi vetæhèn t'ime,thot Perəndia,se ti bære kæta tæ thænæ,e ngæ kurseve þær mua t'it bir tæ dashurin.

17. E andai tue bekuar dua tæ t'bekonj e tue shumæ-suar dua tæ bænja tæ rritet fara jote,sa ijzit e kjielliæs e sa ræra mba buzæ tæ deitit,e fara jote ka tæ trazhgonjæ kjitetet e armikjævet.

18. E te fara jote ka t'jen bekuar gjithæ gjindet e dheut,pse ti mæ ke gjegjur zærin t'im.

v a s h d o n n g a f.23

9. E ka t'jet njohur ndær gjindet fara e 'tire,e næ mes tæ popujvet nipærat e 'tire.Kush i sheh do t'i njohænjæ:se kæta janæ fara e bekuane nga Perəndia e

10. ndæ gæzin do t'jen gæzuar tek in'Zot.

Piesë nga libri i Isaïs Profetë
(LXI, 1-10)

Shpirti i Zotit Perëndi është mbi mua: përsë mua më liejti Perëndia, sa t'i thon të vaprëkështet vangjejin: dërgoi mua sa t'i jap kujdes atire ne zëmbërrë të prerë, sa t'i ligjironj shklavëravet ndëjesan, e të verberavet të shohiën.

2. sa të thres vitin e pakjies tek in'Zot, ditën e shpërbimit, sa të përgatzonjë gjithë ata çështet:
3. sa këtire të Sionit çështet janë në lip, t'i jap u lëvdë e jo hi, vaj gëzimi atire në lip, nandil lëvdije e jo shpirt helmi: e ka t'jen thritur liset e dreitaris, bima të Perëndis për të lëvduar mua.
4. E ata kanë të ndertojën vendet të shkretët çështet: kanë t'i ngjallian ata vende të harruama të të mot-çëmëvet: ka t'partrijën kjitetet lënë të vetëm çështet: nga jinit e shkuame.
5. E kanë të vijën të huajit tue kulet delt t'uaja e të bijt e 'tire do t'jen bulkjet e vreshtarët t'aj.
6. E ju ka t'jini thritur priftëria e t'in'Zoti, të dhënët në shërbesa të Perëndis: do t'hani nga të pasurat e gjindëvet e do t'jini të lëvduashmë mbi lëvdi të 'tire.
7. Për dhunën di herësh e mbarrien do t'gazonen mbi piesën e 'tire: se ashtu te dheu i 'tire do t'ken përdi piesë; e gëzimi atire ka t'i jet gjith nònë nbi kriet e 'tire.
8. Përsë u janë Perëndia çështet mirë dreitarin, e dua kekj grabit të falura mua përflijtë e të drejtëvat ka t'i paguanj brengën e vepravet e 'tire tek e vërtetia: e dua bënj me 'të dhiatë të pasosme.

Piesa nga Libri i katrat i Rregjärvet
(IV,8-37)

Një ditë streksi se Eliseu ish e shkoj për në horës të Sumanit:e atie ish një grua e nadhe, e e mbajti të haj bukë. E disa herë i ngisëj të shkoj atei, e ai mbahej atiè të haj bukë.

9. E i tha gruaja burrit e 'saj:pa shih, kan njohur se isht një i sheit ki njeri i Perandis çë shkon këtu disa herë tek na.

10. Pa do t'ibëjën një dhoma, një vend të vogël, e i vum atie një shtrat, një triesë, një thron e një hërnar: e kur i ngjet të shkonjë tek na, vete e rri atiè.

11. E jerdhi një ditë se ai hiri atiè, e vate e rrijti tek ajo dhoma, e atiè u prë.

12. E i tha Gjezit shërbëtorit e 'tij: thritëmë këtë grua Suranite. E ai ja thriti:e ajo vate e u mba përparrë atij.

13. Eliseu i tha Gjezit: thuaji nani ti asaj:shi' ti ke pasur për ne gjithë këtë kujdes; çë mën'të bënj u përtij? Në edhe isht të flitet për tij Rregjit a kries e ushtris? E ajo tha:u rronj në mes të popullit t'in te shpia në pakje.

14. E i tha Gjezit Eliseu: çë do t'bënet për këtë grua? E i tha Gjezi, shërbëtori i 'tij:e çë? ajo ngë ka edhe bij e burri i 'saj ë plak. E i tha Eliseu: thrite.

E Gjezi e thriti e ajo u mba përparrë derës.

16. E i tha Eliseu asaj:në këtë mot, si te këajo herë, ti të rrrosh, e ka t'kesh një bir. E ajo i tha:mos në gënjë, o zot, mua shërbëtoren t'ande.

17. E ajo grua pati, e ju le një bir tek ai mot, tek ajo herë si i kish thënë asaj Eliseu.

18. E diali ju rrit:e streksi njæ ditæ se dolli tæ gjej tæ jatin tek ata çæ kuariæn.
19. E i tha tæ jatit:mæ dæmb kriet.E i jati i tha nji shærbætori:kjelle tek e jæma.
20. E ai e kjelli tek e jæma. E ajo e mbajti dialin mbi glunjæt njera præ niedita : e diali i vdikj.
21. E jæma e mori e e kjelli lart e vate e vuri mbi shtratin e njeriut e Perændis:e mbilli brænda e dolli.
22. E thriti burrin e 'saj e i tha:dærgomæ njæ nga shæbærtoræt,e njæ nga gpmaræt,sa u rrieth e vete njera te njeriu i Perændis e prirem.
23. E ai i tha:pærçæ di do t'vetsh sot tek ai? Ngæ janæ tæ paræt ditæt e moit ,ngæ isht e shtunia. E ajo u pærgjekj:kij pakje,le næ tæ vete.
24. E nglakoi gomaren e i tha shærbætorit e 'saj: eja,jits,nos næ nbaj dhromit:bæn çæ tæ thom.
25. E mori tæ jitsæj e jerdhi njeræ te njeriu i Pe-
rændis mbi malin e Karmelit. E Eliseu tæ parit se ajo
vej,i tha shærbætorit e 'tij:shi' ajo grua e Sunanit.

Rrith nani e jetsi pærpara e t'i thuash:ke pakje ?
je miræ? ti e burri i jit edhe diali ?
E ajo i tha:mira n'pakj.
27. E arrænat çæ arru te mali pærpara Eliseut,ju
shtu te kæmbæt e 'tija. E Gjezi u kjas sa t'e nbaj
langu atij. Por njeriu i Perændis,Eliseu,i tha:Le,se
shærbætorit i 'saj isht næ helme,e Perændia m'e fshehu
kætæ shærbæs e ngæ n'e bæ t'e dija.
28. Ajo i tha: nos u lipa Zotit njæ bir? Ngæ tæ
thash : nos næ kjeshò ?
29. E Eliseu i tha Gjezit:lith mesin,mirr shkopin t'im

te dora e jote e jets shpeit:se næ pærpiek dhromit ndo njeri dhromit, mos u mba t'i falesh, e næ tæ falet ndo njeri, mos u përgjekj:e vete i vu shkopin t'im mbi fakjen e dialit.

30. E i tha e jama e dialit:rroft zoti e rroft shpirti i jit, næ u dua tæ la tij. E Eliseu u ngre e vate prapa asaj.

31. E Gjezi i shkoi parëvara asaj e vate e i vuri shkopin mbi fakjen e dialit:e ai ngæ kish frimæ e ngæ ndiejti gjæ. E Gjezi u pruar e i duall përpara Eliseut tue tha-næ: ngæ u ngjall diali.

32. Eliseu hiri te shpia e pa dialin tæ vdekur glat mbi shtratin e 'tij.

33. E hiri te shpia e u nbill brënda me dialin, e zu t'i lutej Perëndis.

34. U ngjip mbi shtrat e u shtrua mbi dialin:gojæn e 'tijæ mbi gojæn e atijæ, sit e 'tij mbi sit e atij e duart e 'tija mbi duart e atija, e i frijti e u premis mbi atæ, e misht e dialit u ngroh.

35. Eliseu pra u ngre e zu tæ jitsæj pär næ shpis atei e këtei, e paneta u ngjip e u nde mbi dialin:e diali shtu gogosimæ e hapi gojæn shtatæ heræ e sbilli sit.

36. Eliseu i thriti Gjezit e i tha: thrit gruan Sumanite, e e thriti, e ajo jerdhi e hiri tek ai. E i tha Eliseu:mirr dialin t'ænt.

37. Ajo ju shtu te këmbat e ju fal njera te dheu:c mori dialin e 'saj e dolli. E Eliseu mori e vate næ Galgalæ.

Piesæ nga libri i ISAIS Profeta
(LXII,11-19;LXIV,1-5;)

Kæto fialæ thot in'Zot:kush æ çæ tolkji nga deiti delmerin me delet e 'tija? Ku isht ai çæ vu næ nes t'atire shpirtin e sheitærис s'tija?

12. Ai çæ kjelli Moiseun me tæ dreiten e 'tijækrahu i lævdis sæ 'tija? Ai ndajti pærpara atire ujərat, tue lənæ pær 'tæ njæ nomæ tæ pasosne.

13. Ai çæ i kjelli pær dorie pær næ hone, si njæ kal pær næ shkretiræ, e ata ngæ u lodhæn tæ ndaluar,

14. e si kafsha pær næ fushæ, u sdrip shpirti i Perandis e i kjelli ata:kæshtu si solle popullin t'ənt tue bør pær tij njæ nomæ lævdije.

15. Priru nga kjiellia e vorrej nga shpia e sheitærис t'ənde:ku isht tæ nzehtit t'at, fukjia e jote ? ku isht lipisia e jote e madhe e tæ kjelmerisurit t'at? pse u ke nbajtur me ne ?

16. Por Ti je Ati i jinæ, se Abrani ngæ na njohu e Israeli ngæ di kush jemi: por Ti, o Zot, je Ati i jinæ, shpærblesi i jinæ: çæ mæ para embri i jit æ ki mbi ne.

17. 9æ na le tæ rrahiæm sæ largu nga udhæt t'ote: na thajte zænbrat t'ona mos tæ trambeshim Tij? Priru mbi ne paj tæ shærbætorævet t'atæ, paj tæ faræs tæ trazhgimit t'ənt;

18. se pær pak mot na patæm malin e sheitærис t'ənde armikjæt na kans shkelur Sheitoren t'ənde.

19. Na ndodhemi nani si mæ para, kur ngæ ishæ i zot mbi ne, e kur na ngæ thrisiaæ embrin t'ənt mbi ne.

- XLIV,1. Næ sbillie kjiellin e vije Ti kætu,ki't'dridhe-shin malet e ki't'joseshin pærpara Tij:
2. Si dillæt joset pærpara ziarrit,armikjt ka t'jen die-gur nga ziarri e embri i jit ka t'jet i njohur ndær ar-nikjt.Pærpara fakjes t'ænde gjindet kanæ tæ tærbonden;
3. kur tæ bæsh kæto tæ lævduashne:malet do t'i narrænje:dridhæma.
4. Çæ mot e jetæ kurr na keni gjegjur,as sit t'anæ kanæ par Perændi t'jeræ vec Tij,e veprat t'ote çæ do t'bæsh atireve çæ janæ e presiæn ndæjesæ.
5. Pærse do t'i dalnjæ pærpara atire çæ e presiæn e çæ bæjæn tæ dreiten: e ata do t'kujtonen nga udhæt t'ote.

Piesa nga libri i JEREMIS Profeta
(XXXI, 31-34)

Këto fiala thot in'Zot:shi'se vijen ditët, e U dua të bënj një dhiatë të re me shpin e Israelit e ne shpin e Judha.

32. Jo si dhiatën çë bëra me tatarat e 'tire tek ajo ditë, kur i zura për dorie sa t'i tilkjmëja nga dheu i Egjiptit, se ata ngë u mbajtin te dhiata jime, e U i lë-reva pa kujdes, thot in'Zot.

33. Se kajo isht dhiata jime çë U do t'bënj me shpin e Israelit, të shkuarit ato ditë, thot in'Zot:dua t'i jap ne hir ligjan t'ime te mendia e 'tire, e dua t'ja shkruanç te zëmbra e 'tire, e ka t'i jen atire U Perandia e ata ka të në jen popull jimi.

34. E ngë ka t'nbasonen më nga-një shokun e 'tij e nga-një vëllaun e 'tij, tue thënë:njihni Perandin, se të gjithë kanë të më njohian Mua çë ka më i vogali njera te më i madhi i 'tire: se U dua t'i jen atire afar tue ndëjier pa-drejtërit e 'tire, e s'dua të kujtonj mëkatët e 'tire.

Piesæ nga libri i DANIELIT Profeta
(III,1-88)

Mbi tetembædhietæ vietæ çæ ish rrekj Nabukodonosorri bari njæ statullæ t'artæ:e lartæ trezet kute,e gjera gjashtæ kute,e e vu shtuara te fusha e Duræs ndæ krahinæ tæ Babilonæs.

2. E dærgoi tæ thænæ,sa tæ nbæjidheshin tæ gjithæ bashk:tæ Parat,krerat e ushtris,zotæronjæsit e vendit gjikætaræt,kaptenjæt,ligjætaræt,Plekjt,zotærit e nbædha ndæ pushtetie e gjithæ urdhuronjæsit e krahinavet tæ vijen pær tæ uruar statullæn.
3. E u nbæjodhæn tæ gjithæ bashk:zotæronjæsit e vendit Paræsia,krietaræt,kaptenjæt,gjikætaræt,Plekjæsia,zotærit e nbædha ndæ pushtetie e gjithæ urdhuronjæsit e krahinavet,sa tæ urojan statullæn çæ vu rregji Nabukodonosorri . E atiè shtuara rrijen tæ gjithæ pærpara statullæs.
4. E letçitæsi luriti me njæ zæ tæ fortæ:Juve isht e thuhet,juve,popuj,farm e gluhaæ.
5. Te hera kur tæ gjegjij t'i bien zænores,flojeræs,kjitharæs(tsinganæs),zamaræs,nsaltrit,topanit e gjithæ atire llojè musiktare:tek ajo heræ gjithæ ju tæ binipræmistæ tue u falur statullæs t'artæ çæ kætu vu-ri shtuara Nabukodonosorri rregji.
6. E kush mos ngæ rafshit præmist t'i falet,tek ajo heræ,ai ka t'jet shtur te furri ne ziarr i diegur.
7. Andai kle se kur popujit gjegjæn t'i bijæn zænores,flojeræs,kjitharæs,zamaræs,nsaltrit,topanit e gjithæ atire llojè musiktare,ran præmist gjithæ popujit,fa-rat e gluhaæ,e ju falæn statullæs t'artæ çæ vu atie Nabukodonosorri rrekj.

8. Ahierna tsa burra Kaldenja vanæ e ngalesan te rregji Judenjt
9. tue thænæ:rrofshe gjith-monæ , o rrekj !
10. Ti,o rrekj,ke shtur zarin me urdhur,se nga-njeri çæ tæ gjegjurit çæ gjegjet t'i bien zænores,flojeræs,kjtharæs,zamaræs,mæsaltrit,topanit e gjithæ atire llojè musikie
11. mos ngæ rafshit prænist tue u falur statullæs t'artæ,ka t'jet shtur te furri i dhezur me ziarr.
12. Janæ tsa burra Judhenj,çæ ti ke vænæ mbi veprat e krahinæs tæ Babilonæs: Sedrahu,Misahu,Abdenagoi,tæ çilat ngæ nuartin vesh urdhurimin t'ænt,e ata ngæ i luten perændiravet t'atæ e ngæ i falen statullæs t'artæ çæ ti vure.
13. Ahierna Nabukodonosorri u træbua e te mbæria e 'tijæ i tha t'i sielliæn pærpara Sedrahun,Misahun e Abdenagoin:e i klenæ kjellur pærpara rregjit.
14. E Nabukodonosorri mori e i tha atire:værteta se ju Sedrah,Misah,Abdenagò,ngæ i lutij perændiravet t'in e se ngæ i falij statullæs çæ u vura?
15. Andai ju nani do t'e bæni,se,si tæ gjegjij t'i bien zanoræs,flojeræs,kjitharæs,mæsaltrit,topanit e gjithæ atire llojè musiktare,ju do t'bini præmista e t'i falij statullæs çæ u bæra:næ mos ngæ doni t'i falij,tek ajo heræ ka t'jini shtur te furri i nzeht ne ziarr. E kush æ Perændia çæ do t'ju shkulnjæ 'n duarshit t'ime?
16. E ju pærgjegjæn Sedrahu,Misahu e Abdenagoi,tue thænæ rregjit Nabukodonosorr: Ngæ i duhet se na tæ t'pær-gjegjemi mbi kæta fialæ.

17. Pse isht Perandia i jinæ næ kjiell, kuj na i lutemi:
Ai mændæ tæ na shkulnjæ nga furri i diegur me ziarr,
Ai do t'na ruanjæ,o rrekj,nga duart t'ote.
18. Næ mos na ruashit edhe:t'e die kurora jote,o rrekj,
sc na ngæ i luteni perandiravet t'atæ,e na ngæ i præ-
nisemi statullæs çæ ti bære.
19. Ahierna Nabukodonosorri u fri e u træbua fort,edhe
fitira e fakjes 'tijæ u ndarrua kundra Sedrahut,Misahut
e Abdenagoit,e i tha tæ digæjæn furrin pær shtat heræ
næ shumæ se kur dukej i diegur.
20. E i tha tsa burrave tæ fortæ næ ushtri,tæ lidhien
pær kæmbashit Sedrahun,Misahun e Abdenagoin,e t'i shti-
jæn brænda furrit tæ diegur me ziarr.
21. Ahierna ata burra klenæ lidhur me gjithæ snterin e
brekt e 'tire,me kæsulat e ne kæputsat e me gjithæ tæ
veshurat e 'tire;e klen shtur næ mes tæ furrit tæ flakt
me ziarr.
22. Pse fiala e rregjit po i shtij tæ bænej shpeit.
E furri ish diegur pær shtat heræ næ shumæ se t'jera
heræ:flaka e ziarrit vrou ata burra çæ muarnæ e
shtun Sedrahun,Misahun e Abdenagoin.
23. Por kæta tæ tre,Sedrahu,Misahu,e Abdenagoi ran
tæ lidhur næ mes tæ furrit çæ digjej:
24. E zun tæ jitsian atei e kætei tue lævduar Peræn-
din,tue bekuar t'an'Zonæ.
25. E Azaria u nba shtuara tue parkalesur kæshtu:e
næ mes tæ ziarrit ai sbilli gojæn e 'tijæ e thæshæj:
26. Bekuar je Ti,o Zot,Perandia i tatæravet t'anæ;
e embri i jit æ i lævduashim pær gjith-monæ.

27. Se ti je i dreit mbi gjithkjish na ke bær neve,e ve-prat t'ote janæ tæ vørteta,e tæ dreita janæ udhæt t'ote e gjithæ gjikjet t'atæ janæ tæ vørtetaæ.
28. E gjikime swæ vørtetie ti bare mbi gjithæ kæto çæ na prure neve,e mbi Jerusolinin kjitetin sheit e tatæ-ravet t'anæ:pse kæto tæ gjitha ti na i ke dærguar ne tæ vørtetie e ne drcitæri mbi ne pær makatæt t'ona:
29. parçæ na makatruan e lama ligjan t'ænde tue rrahur llargu kak Ti,e te gjith-kjish na tæ ftesæ;
- 30.e ngæ gjegjæn urdhurinet t'atæ:na ngæ i ruajtin e ngæ bæm ashtu si ti urdhurove,sa edhe tæ na streksæj miræ.
31. E gjith-kjish sa do na prure neve,e gjith atæ çæ na bære neve,Ti e bære ndæ gjikim tæ vørtet:e na ke dhæns te duart e armikjævet tæ pa-ligjæ,tæ kekj shumæ tæ pa-lutshim,e te duart e nji rregji tæ pa-dreitæri,e næ tæ ligut te gjithæjeta.
33. E nani na ngæ nændæ tæ sbilliam gojan t'anæ:dhu-næ e turpæri na ngæt neve shærbætorævet t'atæ e tæ lutshævet t'atæ.
34. Mos na le gjith-næna paja t'enbrit t'ant,e mos prish dhiaten t'ænde;
35. E mos na ndsir lipisin t'ænde paja t'Abraamit çæ Ti deshe miræ,e pajo t'Isakut shærbætorit t'ant:
36. paja t'atire kuj ti i fole tue taksur,se ki't'rritej shumæ fara e 'tire,sa ijzit e kjiclliæs e sa rara mba buza tæ deitit.
37. Pse,o Zot,nani na jeni bær næ tæ paktit te gjithæ gjindet,e jeni sot tæ poshter te gjithæjeta par makatæt t'ona.

38. E te ki not ngë keni na as një krie, as një profeta, as një urdhuronjës:na ngë keni as një flijë, as një gjith-të-diegurshme, as një të falur, as liven(klen), as një vend edhe ku të bien Tij dhureti të parat pemë të dheut,
39. sa të gjejmë ndajesë:por me zëmbërë të prerë e me shpirt përunjësie na klofshin pritur mirë ngak Ti.
40. Si kur tue diegur gjithë e desh e terë e nijëra kjen-kjë të naimë, kështu kloft përpëra Tij sot flija jona e u nbaroft Tij e palkjicë:se mos të ken dhunë ata çë kana beson tek Ti.
41. E nani ne gjithë zëmbërë na të vijen prapa e të trënbemi Tij e kerkojen fakjen t'ende.
42. Mos të na duash në dhunë, po bën ne ne si të thot butësia e jote, lipisia e nadhe jote.
43. E Ti na ruan ne fanasmët t'ote e jipi lëvdì embrit t'ënt, o Zot.
44. E patçin mbarrie gjith'ata çë i dëftojan të zezat shërbatorëvet t'atë e klofshin turpëruar nga gjithë pushtetia e jote:fukjia e 'tire le të drëmonet.
45. Le të njohian se Ti je Zoti, Perëndia njëth i vetëm, i lëvduashin mbi gjithë jetën
46. E shërbatorët e rregjit çë i kishën shtur atie branda, ngë sosiën tue diegur furrin me naftë, me pitçë, me shtupë e me dru dhërish.
47. E flaka ngrëhej mbi furrin lartëzë si dizet e nandë kuta.
48. E u sgjerua e bë dhron e dogji ata Kaldenja çë gjëti rrëth furrit.

49. E Engjælli i Perændis u sdrip e rríj bashk ne Azarin e ne shokt e 'tij brænda furrit,e nbaj largu atire flækæn e zierrit te furri.
50. E næ mes tæ furrit bæj tæ frij njæ eræ notije:e ziari ngæ i ngisæj ata nosgjakun fare,as i helmoi,as i bæ atire gjæ tæ kekj.
51. Ahierna tæ tre si gjith-nji goje ata kændojaen e lævdojaen e bekojaen Perændin te furri tue thæmæ:
52. Bekuar Ti je,o Zot,Perændia i tatæravet t'anæ, i kænduashim e i lartæsuashim pær gjith monæ: e bekuar embri i sheit i lævdís t'ænde,i kænduashim e i lartæsuashim pær gjith monæ.
53. Bekuar je Ti te faltoreja e lævdís t'ænde tæ sheite, i kænduashim e i lartæsuashim pær gjith monæ.
54. Bekuar ti je çæ sheh te næ tæ huntit,ti çæ jes mbi Hjeruvint,i kænduashim e i lartæsuashim pær gjith monæ.
55. Bekuar je Ti mbi thronin e lævdís sæ rregjæris t'ænde,i kænduashim e i lartæsuashim pær gjith monæ.
56. Bekuar je Ti mbi tæ ndejturit e kjiellies,i kænduashim e i lartæsuashim pær gjith monæ.

K E N K A E T R E DIELMAVET TÆ SHEITE
(Dan. III, 57-88)

T'æn' Zonæ po bekoni
ju tæ gjithæ vepra tæ Perændis .

T'æn' Zonæ po lævdoni edhe tæ lartæsoni Atæ par gjith
nonæ.

58-59. T'æn' Zonæ po bekoni
-ju angjij tæ Perændis, ju kjiellia.

t'æn' Zonæ po lævdoni edhe tæ lartæsoni Atæ par gjith
nonæ.

60-61. T'æn' Zonæ po bekoni
-ju ujæra tæ gjithæ çæ jini nbi kjielliat
-ju gjithæ ushtri tæ Perændis,

t'æn' Zonæ po lævdoni ...

62-63. T'æn' Zonæ po bekoni
-ju diell e hænzæ , ju ijzæ tæ kjielliæs,

t'æn' Zonæ po lævdoni ...

64-65. T'æn' Zonæ po bekoni
-ju shira dhe laksira, ju eræ tæ gjithæ

t'æn' Zonæ po lævdoni ...

66-67. T'æn' Zonæ po bekoni
-ju ziarr e tæ ngroht , ju tætin e vapæ,

t'æn' Zonæ po lævdoni ...

68-69. T'ən'Zonə po bekoni

-ju laksira e brima , ju akull e tə ftioht
t'ən'Zonə po ləvdoni edhe tə lartəsoni

Atə pər gjith nənə

70-71.T'ən'Zonə po bekoni

-ju tə ngrim edhe sborə,ju shkreptina
edhe miegulla
t'ən'Zonə po bekoni ...

72-73. T'ən'Zonə po bekoni

-ju dritə e tə nətert , ju ditə edhe netə.
t'ən'Zonə po ləvdoni ...

74,75,76. T'ən'Zonə po bekoni

-ju dhe,male e rehje,ju bina tə gjithə
çə lehij nga dheu
t'ən'Zonə po ləvdoni ...

77,78,79. T'ən'Zonə po bekoni

-ju kronje,ju dejtəra e lume,ju pishkja tə
gjithə çə livizij te ujarat,
t'ən'Zonə po ləvdoni ...

80-81. T'ən'Zonə po bekoni

-ju zoga tə gjithə tə kjielliəs,
-ju kafsha t'gjitha tə egəra e tə buta
t'ən'Zonə po ləvdoni ...

82-83. T'æn'Zonæ po bekoni
-ju bij tæ njerzævet edhe Israeli

t'æn'Zonæ po lævdoni edhe po lartæsoni Atæ
pær gjith monæ.

84-85. T'æn'Zonæ po bekoni
-ju priftæria e Perændis, ju sharbætora
tæ Perændis.

86-87. T'æn'Zonæ po bekoni
-ju frina e shpirtra tæ tæ drejtævet
-ju shejtære e ju ne zænbræn tæ pærujæne.

t'æn'Zonæ po lævdoni ...

88. T'æn'Zonæ po bekoni
-ju Ananì , Azari , Misaill
t'æn'Zonæ po lævdoni ...

T'æn'Zonæ po bekoni, ju Apostoj, ju Profetæra,
ju Martæra.

t'æn'Zonæ po lævdoni ...

Levdi past ...

T'æn'Zonæ po bekojæm: Atin, Birin e Shpirtin Shejt
Po lævdojæm edhe po lartæsojæm Atæ pær gjith monæ.

nani e gjith monæ ...

T'æn'Zonæ po kændojaen, po e lævdojaen edhe i pærmiseni,
tue lævduar e tue lartæsuar Atæ pær gjith monæ.

Piesæ nga pistulla çæ shæn Pali i dærgoi RRomenjævet
(VI,3-11)

Vællezær , sa-do u pagæzuam mbæ Krishtin , na u pagæzuam
mbæ vdekjen e 'tij.

4. Andai ne pagæzimin mbæ vdekjen e 'tijæ na klenæ
varræzuar bashk me Atæ;sa , ashtu si Krishti u ngjall
sæ vdekurish pær lævdi tæ t'Jatit,ashtu edhe na jetsiam
te njæ gjellæ e re .

5. Pse næ u len bashk tek Ai mbæ tæ glarit e vdekie
sæ 'tijæ:do t'i jemi edhe tæ tæ ngjallurit.

6. Se e din kætæ:se njeriu jinæ i vietær kle bashk
ngrikj sa tæ shkatarronej kurmi i mækataes,mos tæ
shærbejæm næ na mækaten:

7. pærçæ ai çæ æ i vdekur , ka tæ dreit nga mækata.

8. E næ na vdikjan me Krishtin , keni besæ se do te
rrojem edhe me Atæ.

9. Pse din se Krishti posa u ngre sæ vdekurish,ngæ
vdes næ,e vdeklia e 'tijæ ngæ e zotaron næ.

10. Se , tæ ket vdekur Aì,vdikj pær mækaten,po njæ
heræ vetæ:æ tæ rronje , rron Aì pær Perændin.

Ashtu edhe ju tæ ndælgonij si tæ vdekuræ mækataes , por
tæ gjallaæ pær Perændin tek in'Zot Iisu Krishti.

n a v e n d t æ Alliluiæs kændojaæ Ms.LXXXIin:

A n a s t a o T h e ð s

N g r e u , o P e r æ n d i , e g j i k o j e t æ n , p s e t ' o t e t k a n æ t æ j e n
g j i t h æ g j i n d e t .

1. Perændia u nba ndæ mbledhie perændirash:atiè næ mes
t'atire Aì bæn ligjæ.
2. Njera kur ju do t'gjikoni pa-drcitærì, e do t'i ruani
fakjen tæ mækatruanævet.
3. Jipni ligjæ tæ likshtit e tæ varfærit : jipni
tæ dreit tæ nierit e tæ urmit.
4. Shpætoni tæ urmin e tæ vapkun : ju shkulnie
'n dorie tæ kekjít.
5. Ata ngæ njohian, ngæ kanæ ndælgim: jetsian næ t'erræst.
Le tæ tunden tæ gjitha kjændrat e jetæs.
6. U thash: ju jini perændira: e tæ bijt e tæ Lartit
jini ju tæ gjithæ.
7. Por edhe ju kini tæ vdisni, si njeræzzæ:
e tæ bini edhe si nja nga urdhuronjæsit.
8. Ngreue, o Perændi, e gjiko jetæn, pse t'otet
kanæ tæ jen gjithæ gjindet.

Queste profezie, nella traduzione del
compianto Vescovo Mons. Paolo Schirò, sono state lette
nella Cattedrale di S. Demetrio il Sabato Santo da
diecine d'anni. Per maggiore conodità dei fedeli

oggi vengono ciclostilate, copiate fedelmente da
i Manoscritti in nostro possesso.

Lo stesso è stato fatto l'anno scorso per i
Vangeli del Giovedì Santo.

Hora e t'Arbareshavet 28 - III - 1965 .

